


Mbas moshës 50-vjeçare unë informohem!

Masat parandaluese ndaj kancerit të zorrës së trashë



swiss
cancer
screening

Përmbajtja

Parandalimi i kancerit të zorrës së trashë – Në një shikim	3
Informacione mbi kancerin i zorrës së trashë	4
Parandalimi i kancerit të zorrës së trashë	6
Masat parandaluese ndaj kancerit të zorrës së trashë	6
Metodat e ekzaminimeve parandaluese	7
Sa efektiv është parandalimi i kancerit të zorrës së trashë?	10
Pjesëmarrja në masat parandaluese	12
Fjalorth terminologjik	16
Informacione të mëtejshme	18
Adresa	20

Parandalimi i kancerit të zorrës së trashë – Në një shikim

Në këtë broshurë do të gjeni informacionet më të rëndësishme mbi temën «Parandalimi i shfaqjes së kancerit i zorrës së trashë».

Çfarë është parandalimi i kancerit të zorrës së trashë?

Ka disa kontrolle mjekësore për zbulimin sa më të hershëm të kancerit i zorrës së trashë ose të fazave paraprake të tij. Për këtë ekzistojnë dy metoda të ndryshme.

Kush mund të marrë pjesë në programin parandalues të kancerit i zorrës së trashë?

Kjo mundësi i ofrohet të gjithë personave mbi moshën 50-vjeçare.

Përse është kaq i rëndësishëm parandalimi i kancerit të zorrës së trashë?

- Sepse më pak njerëz sëmurën nga kanceri i zorrës së trashë.
- Sepse kanceri e zorrës së trashë mund të luftohet më lehtë.
- Sepse më pak njerëz vdesin nga kanceri i zorrës së trashë.

Cilët janë përparësitë e pjesëmarrjes në parandalimin të kancerit i zorrës së trashë?

- Ju mund të rrini të qetë nëse rezultati i kontrollit është negativ.
- Ju do të merrni konsultë të përshtatshme nëse rezultati i kontrollit del pozitiv si dhe do të bisedohet me ju për procedurat e mëtejshme.
- Mbas kontrollit mund të eliminohen fazat paraprake të krijimit të kancerit i zorrës së trashë. Kështu ulet ndjeshëm rrezikshmëria e sëmundjes nga kanceri i zorrës së trashë.

Përse është i rëndësishëm zbulimi i hershëm i kancerit i zorrës së trashë?

- Shanset janë të mëdha për kurimin dhe shërimin e kancerit.
- Trajtimi mjekësor është më pak intensiv dhe më pak i lodhshëm për pacientin se në rastin e trajtimit të kancerit në një fazë më të avancuar.

Informacione mbi kancerin i zorrës së trashë

Shifra dhe fakte

Në Zvicër kanceri i zorrës së trashë është lloji i tretë i kancerit më i shpeshtë tek meshkujt dhe lloji i dytë më i shpeshtë tek femrat.

Sa persona sëmurën me kancer të zorrës së trashë?

Në Zvicër sëmurën 4300 persona në vit nga kanceri i zorrës së trashë.

Sa persona vdesin nga kanceri i zorrës së trashë?

Në Zvicër vdesin 1700 persona në vit si pasojë e sëmundjes me kancer të zorrës së trashë.

Kush mund të sëmuret me kancer të zorrës së trashë?

Me kancer të zorrës së trashë sëmurën shumica e personave mbi moshën 50-vjeçare. 4 në 100 persona në Zvicër sëmurën para moshës 80 vjeç me kancer të zorrës së trashë.

A shërohet kanceri i zorrës së trashë?


Shanset për t'u shëruar janë të mëdha, nëse kanceri i zorrës së trashë zbulohet në fazat e tij të hershme.



Zorra e trashë

Zorra e trashë është një pjesë e zorrës. Zorra përbëhet nga tre segmentë:


- 1 Zorra e hollë
- 2 Zorra e trashë
 - A ngjitëse
 - B zbritëse
- 3 Zorra e drejtë (rectum)



Si zhvillohet kanceri i zorrës së trashë?

- Mukoza në zorrën e trashë dhe në zorrën e fundit mund të ndryshojë me kalimin e kohës, ku mund të shfaqen enjtje të vogla, të cilat quhen ndryshe edhe polipe.
- Polipet shfaqen shpeshherë. Mbi 30 në 100 persona në moshën mbi 65-vjeçare kanë këtë lloj polipi në zorrën e trashë.
- Shumë polipe nuk janë të rrezikshme për shëndetin. Ato krijohen nga keqformimet, grumbullimit i yndyrnave ose nga inflamacionet e vogla.
- Polipe të tjera krijohen nga shumimi benign në inde, që do të thotë se këto polipe rriten nga mukozja. Ky lloj i veçantë polipesh quhet adenomë.
- Nga këto adenoma mund të krijohet kanceri.
- Që një adenomë të shndërrohet në kancer duhet të kalojnë zakonisht 10 deri 15 vjet. Por ka të ngjarë që kanceri të lindë edhe brenda më pak vitesh.
- Nga 100 adenomë më pak se 5 prej tyre zhvillohen në kancer.
- Adenomët e mëdha kanë shpesh gjakrrjedhje. Por ky gjak nuk është i dukshëm me sy të lirë gjatë jashtëqitjes.

Zhvillimi i një adenome në kancer zgjat mesatarisht 10 deri 15 vjet.



Cilat janë shenjat e para dalluese të kancerit të zorrës së trashë?

Është mirë të kontrolloheni tek mjeku nëse keni këto simptoma:

- Gjak në jashtëqitje
- Dispepsi (dhimbje ose një ndjenjë diskomforti në pjesën e sipërme të mesme të stomakut)
- Ndryshimi i shprehive të jashtëqitjes (daljes jashtë)
- Humbje e pashpjegueshme e peshës
- Lodhje e vazhdueshme

Me këto simptoma shumicën e rasteve kanceri në zorrë është tashmë në fazën përparimtare. Prandaj parandalimi është shumë i rëndësishëm. Drejtojuni mjekut specialist, nëse vini re këto simptoma.

Parandalimi i kancerit ndaj zorrës së trashë

A mund të mbroheni plotësisht nga kanceri i zorrës së trashë?

Nuk ekziston një mbrojtje absolute ndaj kancerit të zorrës së trashë. Por ju mund të ulni rrezikshmërinë ndaj kësaj sëmundjeje.

Çfarë mund të bëni?

Ju mund të kujdeseni për një stil i shëndoshë jetese:

- Ushqeheni çdo ditë me fruta dhe perime.
- Ushqeheni sa më pak me mish të perpunuar industrialisht, p.sh. sallam apo salçice.
- Lëvizni shumë dhe rregullisht.
- Përpiquni të ruani peshën e duhur.
- Mos pini shumë alkool dhe mos pini duhan.

Informacione të mëtejshme i gjeni në faqen e internetit të Krebsliga, në rubrikën «Parandalimi»: www.krebsliga.ch/krebs-vorbeugen.

Masat parandaluese ndaj kancerit të zorrës së trashë

Cilat janë masat parandaluese ndaj kancerit të zorrës së trashë?

Ka disa ekzaminime mjekësore, ku zbulohet shumë herët nëse dikush ka kancer të zorrës së trashë. Në këto ekzaminime mund të dallohen edhe ato ndryshime në zorrë, të cilat më vonë mund të kthehen në kancer të zorrës së trashë. Këto ekzaminime paraprake duhen përsëritur rregullisht.

Për kë janë të përshtatshme masat parandaluese ndaj kancerit të zorrës së trashë?

Masat parandaluese janë të përshtatshme për të gjithë personat mbi moshën 50-vjeçare, të cilët nuk ndejnë asnjë simptomë.

Përse duhen marrë masat parandaluese nga kanceri i zorrës së trashë?

Sa më herët të zbulohet kanceri i zorrës së trashë ose faza e tij e hershme, aq më të mëdha janë shanset e shërimit. Falë masave parandaluese:

- vdesin më pak njerëz nga kanceri i zorrës së trashë.
- kanceri i zorrës së trashë mund të kurohet që në fazën fillestare.
- mund të largohen shkallët paraprake të kancerit (polipet) dhe me këtë të parandalohet krijimi i kancerit të zorrës së trashë.

Parandalimi i kancerit të zorrës së trashë ndikon pozitivisht. Kjo është vërtetuar nga kërkimet shkencore.

A është i limituar parandalimi i kancerit të zorrës së trashë?

Kanceri i zorrës së trashë mund të zbulohet apo parandalohet herët tek shumica e personave që bëjnë ekzaminimet mjekësore parandaluese. Por deri tani nuk ekziston ndonjë test, i cili zbulon 100% të gjitha llojet e kancerit që në fazën e tij të hershme.

Në periudhën kohore midis dy ekzaminimeve mjekësore parandaluese ekziston gjithmonë rrezikshmëria për t'u sëmurë me kancer të zorrës së trashë. Prandaj është e rëndësishme që të pyesni gjithmonë mjeken apo mjekun tuaj, nëse ndjeni simptomat e sëmundjes.

Metodat e ekzaminimeve parandaluese

Ekzistojnë dy metoda të rëndësishme ekzaminuese, të cilat rekomandohen në Zvicër:

- Testi i gjakut në jashtëqitje (emri i shkurtuar: FIT, Fekal Imunolog Test)
- Kolonoskopia


Çfarë është testi i gjakut në jashtëqitje? (FIT)?

Kanceri i zorrës së trashë në fazën fillestare lëshon shpeshherë pak gjak. Por ky gjak nuk mund të shihet me sy të lirë në jashtëqitje. Prandaj bëhet testi FIT, me të cilin mund të maten shumë thjeshtë gjurmët e gjakut në jashtëqitje. Për testin nevojitet një kampion i vogël i jashtëqitjes. Ky test mund të bëhet edhe në shtëpi.

Çfarë është kolonoskopia?


Kolonoskopia bëhet nga një mjeke specialiste ose një mjek specialist. Kjo specialiste apo ky specialist quhet në gjuhën mjekësore: mjeke gastroenterologe ose mjek gastroenterolog. Ata janë të specializuar për sëmundjet e zorrës. Mjekja ose mjeku nëpërmjet anusit kalon në zorrë një tub me një kamerë të vogël, nëpërmjet së cilës mund të shikojë të gjithë zorrën. Ky tub quhet kolonoskop.

Krahasimi i dy metodave



Ekzaminimi i gjakut të padukshëm në jashtëqitje (FIT)

Sa shpesh?	Testi duhet të përsëritet çdo 2 vjet.
Si funksionon?	<ul style="list-style-type: none">• Merret një kampion i jashtëqitjes për testim. Kjo mund të bëhet edhe në shtëpi.• Kampioni dërgohet me postë.• Një laborator i caktuar ekzaminon kampionin e jashtëqitjes.• Nëse gjendet gjak, atëherë bëhet një kolonoskopi për të sqaruar dyshimet.
Sa janë kostot e testimit?	Testi është me çmim të arsyeshëm.
Cilat janë dobritë?	<ul style="list-style-type: none">• Ky lloj testi nuk ka nevojë për përgatitje.• Testi mund të bëhet lehtë dhe shpejt.• Falë këtij testi është më pak e nevojshme kolonoskopia.
Sa i besueshëm është testi?	Nëse testi përsëritet çdo 2 vjet, besueshmëria është e lartë.
Cilat janë mangësitë?	<ul style="list-style-type: none">• Testi duhet të përsëritet çdo dy vjet.• Ka raste që gjaku i gjendur në jashtëqitje nuk ka lidhje me kancerin apo adenomin.



Ilustrim: Felix Burda Stiftung

Kolonoskopia

Sa shpesh?

Kolonoskopia duhet bërë një herë në 10 vjet.

Si funksionon?

- Për këtë ekzaminim duhet të mbahet një dietë e veçantë dhe të merren ilaçe, të cilat pastrojnë zorrën. Dieta mbahet në shtëpi, gjithashtu edhe ilaçet merren në shtëpi.
- Kolonoskopia bëhet ose në një klinikë mjekësore ose në spital.
- Zakonisht do të merrni qetësues, që gjatë kolonoskopisë të mund të jeni të relaksuar.
- Ekzaminimi zgjat rreth 30-45 minuta. Nëse duhet t'ë largohen polipet, atëherë Kolonoskopia zgjat edhe më shumë.

Sa janë kostot e testimit?

Ky ekzaminim është i shtrenjtë.

Cilat janë dobیتë?



- Ky është testi më i mirë për të dalluar polipet, përpara se prej tyre të zhvillohet kanceri.
- Polipet mund të hiqen menjëherë gjatë kontrollit.

Sa i besueshëm është testi?

Rezultatet janë shumë të besueshme, nëse përgatitjet në shtëpi janë bërë si duhet.

Cilat janë mangësitë?



- Ekziston një rrezik shumë i vogël që testi të shkaktojë komplikime të rënda si për shembull dëmtim të zorrës ose shumë gjakëderdhje. Këto komplikime mund të ndodhën përafërsisht tek 2 në 1000 raste.
- Nëse merrni qetësues, atëherë nuk lejohet të ngisni automjete në 12-24 orët e ardhëshme.

Sa efektiv është parandalimi i kancerit të zorrës së trashë?


Efektshmëria e masave parandaluese është vërtetuar shkencërisht. Në rastin e kontrolleve të rregullta parandaluese vdesin më pak se gjysma e njerëzve nga kanceri i zorrës së trashë.

Kjo do të thotë se në 100 persona:

Pa kontrolle parandaluese: 2 persona vdesin para moshës 80-vjeçare nga kanceri i zorrës së trashë.


Me kontrolle të rregullta parandaluese: më pak se 1 person vdes para moshës 80-vjeçare nga kanceri i zorrës së trashë.

Këto shifra bazohen në ekzaminimet e bëra, për këtë arsye janë të përafërta. Studimet shkencore po përpiqen që këto të dhëna të jenë më të sakta. Prandaj është e rëndësishme të dihet se nuk mund të parashikohet për secilin person me siguri të plotë, nëse ai në të ardhmen do të sëmuret apo jo.




Efektshmëria e testit «gjak në jashtëqitje»

(Tek pjesëmarrja të rregullt në testim për një periudhë kohore 10-vjeçare)



Efektshmëria e kolonoskopisë

(Të testuar vetëm një herë)



Të dhënat e përmendura janë marrë nga studimi i E. J. Grobbee et al., publikuar në vitin 2019 në revistën „Gastroenterologjia klinike dhe Hepatologjia“ („Clinical Gastroenterology and Hepatology“, DOI: <https://doi.org/10.1016/j.cgh.2019.08.015>).

Pjesëmarrja në masat parandaluese

Nëse dëshironi të merrni masat parandaluese, duhet të keni parasysh pikat e mëposhtme:

1. Informimi

Informoheni mbi mundësitë e parandalimit të kancerit të zorrës së trashë. Lexoni mbi metodat e mundshme dhe mbi avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Nëse keni pyetje, drejtohuni mjekes apo mjekut tuaj, ose shkoni në farmaci.

2. Verifikimi

Verifikoni nëse oferta mbi masat parandaluese ju përshtatet nga ana mjekësore. Për këtë mund t'ju përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme:

Pjesa e parë: A keni një nga simptomat e mëposhtme?	Po	Jo
Keni humbje në peshë dhe nuk e dini përse.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Keni shqetësime të pazakonta gjatë tretjes. (për shembull: dhimbje, diarre ose kapsllëk).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Dalja jashtë nuk është më si zakonisht.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Keni gjak në jashtëqitje.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ndiheni shpesh shumë të lodhur dhe nuk e dini përse.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Pjesa e dytë: A keni një nga faktorët e mëposhtëm të rrezikshmërisë?	Po	Jo
Ju vetë keni aktualisht ose keni pasur kancer të zorrës së trashë ose polipe dhe duhet t'ju nënshtroheni rregullisht kontrollit të kolonoskopisë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Keni një rrezikshmëri të lartë të trashëguar për t'ju sëmurë me kancer të zorrës së trashë (për shembull: sindroma Lynch, një formë e trashëgueshme e kancerit të zorrës së trashë, pa formim paraprak të polipeve).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Vuani nga një sëmundje inflamatore kronike e zorrëve (për shembull: ulcerozë koliti, Crohn Morbus).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Jeni përgjigje PO në një ose më shumë nga këto pyetje?

Atëherë flisni me mjeken apo mjekun e shtëpisë mbi marrjen e masave të duhura.

Jeni përgjigje JO në të gjitha pyetjet?

Nëse jeni në moshën midis 50- dhe 60-vjeçare ju mund të merrni pjesë në programin parandalues. Nëpërmjet programit parandalues shanset janë të mëdha që ju të mos sëmureni dhe të mos vdisni nga kanceri i zorrës së trashë.

3. Vendimmarrja

Shikoni se çfarë ekzaminimi doni të bëni si masë parandaluese. Çdo ekzaminim është fakultativ. Në rast pasigurie pyesni mjeken apo mjekun tuaj, ose farmacisten apo farmacistin.

4. Pjesëmarrja

Në faqet 14 dhe 15 mund të lexoni mbi ecurinë e mëtejshme sipas metodës së perzgjedhur për ekzaminim mjekësor.

Programe të organizuara për parandalimin e kancerit të zorrës së trashë

Në disa kantone dhe rajone ekzistojnë programe të organizuara për parandalimin e kancerit të zorrës së trashë. Në këto kantone dhe rajone personat në moshën 50- dhe 60-vjeçare në shumicën e rasteve marrin automatikisht një ftesë për të marrë pjesë në këtë program. Në linkun e mëposhtëm mund të shikoni, nëse në kantonin tuaj ka një program të organizuar: www.swisscancerscreening.ch/angebote-in-ihrem-kanton

Sa kushton një ekzaminim parandalues?

Parimisht sigurimi shëndetësor paguan ekzaminimin parandalues.

Nëse banoni në një kanton me program të organizuar:

Atëherë nuk duhet të paguani françizë (Franchise) për sigurimin shëndetësor. Në shumicën e rasteve duhet të paguani vetë 10% kontributin individual.

Nëse banoni në një kanton pa program të organizuar:

Duhet të paguani si në çdo vizitë tjetër mjekësore edhe françizën, edhe 10% kontributin individual.

Si është procedura e ekzaminimit?

Keni vendosur se cilin ekzaminim do të bëni? Më poshtë mund të shikoni se si procedon çdo kontroll.

Nëse vendosni për testimin e gjakut në jashtëqitje (FIT)



Shkoni në farmaci dhe këshillohuni:

- Ju do të rregjistroheni për ekzaminimin parandalues.
- Do t'ju sqarohet testi.
- Do e merrni testin bashkë me udhëzuesin e përdorimit me veti.

OSE



Bëni një takim me mjekun e shtëpisë dhe këshillohuni prej tij:

- Ju do të rregjistroheni për ekzaminimin parandalues.
- Do t'ju sqarohet testi.
- Testin ose mund ta merrni në farmaci së bashku me udhëzuesin e përdorimit, ose në klinikën e mjekut të shtëpisë.



Merrni në shtëpi një kampion të jashtëqitjes për testim dhe dërgojeni në laborator.

E rëndësishme: Gratë nuk duhet të bëjnë testin gjatë menstruacioneve. Kjo mund të çojë në rezultat të gabuar.

Rezultati i testit do t'ju dërgohet me postë.

Testi NUK evidenton gjak në jashtëqitje.

Atëherë **rezultati është negativ**.

93 në 100 persona marrin rezultat negativ.

- Përsëriteni testin çdo dy vjet.
- Nëse në periudhën midis dy kontrolleve shfaqen simptoma, shkoni menjëherë tek mjekja apo mjeku juaj.

Testi evidenton gjak në jashtëqitje.

Atëherë rezultati **është pozitiv**.

Rreth 7 në 100 persona marrin rezultat pozitiv.

- Bëni një takim tek mjekja apo mjeku juaj.
- Do t'ju rekomandohet të bëni kolonoskopi.
- Shpeshherë gjakrrjedhja ka të tjera shkaqe dhe nuk është e shkaktuar nga kanceri.

Nëse vendosni për kolonoskopinë



Bëni një takim me mjekun e shtëpisë:

- Ju do të këshilloheni nga mjekja po mjeku.
- Ju do të rregjistroheni për ekzaminimin parandalues.




Do t'ju bëhet një takim me mjekun specialiste apo mjekun specialist për të bërë kolonoskopinë.



Pregatisni zorrën për kolonoskopinë:

- Mbani dietën e paracaktuar para ekzaminimit.
- Merrni në mbrëmjen para kontrollit dhe në ditën e ekzaminimit preparatin e lëngshëm për pastrimin e zorrëve.
- Është shumë e rëndësishme që zorrët të janë pastruar siç duhet para ekzaminimit.



Ju do të kontrolloheni dhe rezultati do të bisedohet me ju.

Mjekja ose mjeku nuk kanë gjetur asgjë në zorrë.

Kjo quhet kolonoskopi **pa spikatje të veçanta**. Rreth 70 në 100 persona bëjnë kolonoskopi pa spikatje të veçanta.

- Mbas 10 vjetësh mund të bëni një kolonoskopi tjetër.
- Nëse para ekzaminimit të ardhshëm lindin simptoma, shkoni menjëherë tek mjekja apo mjeku juaj.

Mjekja ose mjeku zbulon polipe ose kancer.

Kjo quhet kolonoskopi **me spikatje të veçanta**. Rreth 30 në 100 persona bëjnë kolonoskopi me spikatje të veçanta.

- Polipet hiqen ose kontrollohen.
- Nëse konstatohet kanceri, janë të nevojshme sqarime dhe egzaminime të mëtejshme.
- Mjekja apo mjeku do të bisedojë me ju se si do të procedohet më tej.

Fjalorth terminologjik

Adenomë	Një adenomë është një polip, i cili mund të zhvillohet më vonë në kancer.
Crohn Morbus	Kjo është një sëmundje inflamatore kronike e zorrëve.
FIT, quhet ndryshe edhe FOBTi ose FiOBT	Këto janë inicialet për: Test Imunokimik Fekal (Fäkaler immunochemischer Test). Ky është një test për të evidentuar gjakun e padukshëm në jashtëqitje.
Jashtëqitje	Ndryshe: fekale, feçe. Mbeturinat e ushqimit e të lëngjeve që dalin jashtë organizmit.
Kancer i zorrës së trashë	Ky është kancer që gjendet në zorrën e trashë ose në zorrën e drejtë.
Kolonoskop	Një tub i lëvizshëm, në majë të të cilit është vendosur një kamerë. Me kolonoskopin ekzaminohet zorra e trashë gjatë kolonoskopisë.
Kolonoskopi	Ky është ekzaminim i zorrës së trashë nëpërmjet një instrumenti në formë tubi. Në majë të tij është instaluar një kamerë. Ky tub quhet kolonoskop. Termi mjekësor është kolonoskopi ose endoskopi.
Mjeke gastroenterologe, mjek gastroenterolog	Mjekja ose mjeku i specializuar për sëmundjet në sistemin e tretjes.
Mutacion malinj	Një mutacion malinj është i rrezikshëm për shëndetin. Ai kalon pastaj në kancer.
Mutacione beninje	Një mutacion beninj nuk është i rrezikshëm për shëndetin.

Polip	Kjo është një enjtje e mukozës së zorrës. Shumë polipe nuk janë të rrezikshme për shëndetin. Në këtë rast janë thjeshtë mutacione të vogla në ind, një grumbullim i yndyrnave ose inflamacione të vogla.
Sindroma Lynch	Kjo është një sëmundje e trashëgueshme, nga e cila mund të shfaqet që në moshë të re kancer në zorrën e trashë apo në organe të tjera.
Simptomë	Një simptomë është shenjë e një sëmundje.
Ulcerozë koliti	Kjo është një sëmundje kronike inflamatore në zorrë.
Vështirësitë në tretje	Këto janë shqetësime në zonën e stomakut dhe të zorrëve. Si për shembull: diarre, kapllëk, fryrje në bark ose dhimbje barku.
Zorrë e trashë	Kjo është një pjesë e zorrës. Ajo ndodhet midis zorrës së hollë dhe anusit. Zorra e trashë është pjesa e zorrës, ku zhvillohet më shpesh kanceri.

Informacione të mëtejshme

Nëse dëshironi të dini më shumë, mund të merrni informacione të mëtejshme në adresat e mëposhtme të internetit:

- **Swiss Cancer Screening**

Faqe informimi për zbulimin e hershëm të kancerit dhe ofertat në të gjithë Zvicrën:
www.swisscancerscreening.ch

- **Ofertat në kantonin tuaj:** www.swisscancerscreening.ch/angebote-in-ihrem-kanton

- **Krebsliga:** www.krebsliga.ch/darmkrebs

- **PharmaSuisse:** www.nein-zu-darmkrebs.ch

- **Magendarmliga:** www.gastromed.ch

- **Tek mjekja ose mjeku i shtëpisë, ose në farmaci**

Referenca

- Instituti Federal i statistikave: www.bfs.admin.ch
- www.iarc.fr
- cancer-code-europe.iarc.fr/index.php/de

Të drejtat e pacientëve

www.bag.admin.ch/bag/de/home/medizin-und-forschung/patientenrechte.html

Cilësia e shërbimeve kontrollohet vazhdimisht. Gjithashtu edhe rezultatet e këtyre kontrolleve vlerësohen rregullisht nga një institucion qëndror. Për këto vlerësime as nuk nevojiten dhe as nuk përcillen më tej të dhënat personale si emri apo adresa. Pra të dhënat për vlerësimet nuk ndihmojnë zbulimin e identitetit të një personi të caktuar. Përpunimi i të dhënave personale i nënshtrohet ligjit për mbrojtjen e të dhënave. Për të gjithë personelin e specializuar mjekësor vlen rregulli i ruajtjes së sekretit profesional.

Kriteret e cilësisë

Broshura u përpunua dhe diskutua sipas kriterëve të cilësisë mbi materialet e informimit të pacientëve nga Fondacioni Dialog mbi Etikën (Stiftung Dialog Ethik) dhe Shoqata e Mjekeve dhe Mjekëve/Akademia Zvicerane për Cilësinë në Mjekësi FMH/SAQM.

Sprachen

Këtë broshurë mund ta gjeni edhe në gjuhë të tjera në adresën e internetit www.swisscancerscreening.ch.

Impressum

© Swiss Cancer Screening
Bernë, dhjetor 2019

Redaksia dhe drejtuesi i projektit

Swiss Cancer Screening (PhD Manuela Ocaña)
dhe Unisanté, Lausanne

Konsultimi profesional

Prof. Dr. med. Reto Auer, Guido Biscontin,
Prof. Dr. med. G. Dorta, Esther Kraft, Prof. Dr. med. Urs Marbet,
Dr. Kevin Selby, Daniela Stebler
Falenderojmë pjesëmarrëset dhe pjesëmarrësit e grupit të fokusuar
dhe drejtuesit e programit për vërejtjet e tyre të çmuara.

Lektorat

Eva Ebnöther, gazetare mjekësore dhe shkencore
Bettina Nagler, Capito

Layout

Gisela Burkhalter, Visuelle Kommunikation

Adresa

**swiss
cancer
screening**

Swiss Cancer Screening
Effingerstrasse 33
3008 Bern
info@swisscancerscreening.ch
www.swisscancerscreening.ch



krebsliga

Krebsliga
Krebstelefon 0800 11 88 11
helpline@krebssliga.ch
www.krebssliga.ch

Programi juaj kantonal për parandalimin e kancerit të zorrës së trashë

Programme Bâle-Ville

Vorsorge & Früherkennung
Krebsliga beider Basel
Petersplatz 12
4051 Basel
Tél. 061 319 91 71

Programme Fribourg

Dépistage du cancer Fribourg
Rte. St-Nicolas-de-Flüe 2
Case postale
1701 Fribourg
Tél. 026 425 54 00

Programme Genève

Fondation genevoise
pour le dépistage du cancer
Bd de la Cluse 43
1205 Genève
Tél. 022 708 10 90

Programme Grisons

Darmkrebsvorsorge Graubünden
Krebsliga Graubünden
Ottoplatz 1
7001 Chur
Tél. 0800 300 888

Programme Jura/Neuchâtel

Association pour le dépistage
du cancer JUNE
Rue des Moulins 12
2800 Delémont
Tél. 032 422 58 06

Programme Uri

Kantonsspital Uri
Sekretariat Medizin
Tél. 041 875 51 32

Programme Vaud

Programmes vaudois
de dépistage du cancer
(PVDC) – Unisanté
Route de Berne 113
1010 Lausanne
Tél. 0848 990 990

Programme Valais

Centre de dépistage du cancer Valais
Rue de Condémines 14
Case postale
1951 Sion
Tél. 027 329 04 10